



REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dip. Dip.	2-D/DPK
Nr. Iftaj Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	01-756/16
Data Datum Date	25-02-2016



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 25.02.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2926/15, për zyrtarin e lartë z. Faik Rexhepaj, Drejtor në Komunën e Kamenicës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshëm të Konfliktit të interesit.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokoli AKK-03-02-2926/15, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Faik Rexhepaj, Drejtor në Komunën e Kamenicës.

Gjatë procesit për identifikimin e rasteve të dyshuara për konfliktit të mundshëm të interesit, është identifikuar edhe rasti për zyrtarin e lartë z. Faik Rexhepaj, Drejtor në Komunën e Kamenicës.

Është vërejtur se zyrtari i lartë ka të regjistruar një biznes privatë dhe figuron si person i autorizuar në këtë biznes e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Faik Rexhepaj, ka ardhur ne zyrat tona ku nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar për situatën ne të cilën gjendet si dhe me provat dhe faktet qe posedon AKK-ja.

Zyrtari i lartë z. Rexhepaj, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por është zotuar se brenda afatit ligjor do të bej ndryshimet dhe do te veproj sipas ligjit ne fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit, pasi qe për këtë çështje nuk ka qen i njoftuar përndryshe do ti kishte bërë me kohë ndryshimet.

Me pastaj nga z. Rexhepaj kemi pranuar një dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, ku dëshkohet se z. Faik Rexhepaj ka ber kërkesë për çregjistrim të biznesit.

Duke parë qe zyrtari z. Faik Rexhepaj po vonohet për ti bër ndryshimet kemi kontaktuar me të dhe na ka njoftuar që është në procedurë të çregjistrimit por do të mundohet qe sa ma shpejt ti përfundoj këto obligime edhe pse i kanë dal disa probleme lidhur me këtë çështje .

Agjencia kundër Korrupsionit i ka dërguar edhe shkresën e dytë paralajmëruese palës për ta njoftuar qe nëse nuk ndërmerr veprime për shmangien e gjendjes së konfliktit të interesit brenda afatit ligjor nga pranimi i njoftimit, Agjencia do të veproj konform nenit 18 (paragrafi 8) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik.

Me datën 24.02.2016, kemi pranuar dokumentin zyrtar nga ARBK-ja, ku dëshkohet se z. Faik Rexhepaj, Drejtor në Komunën e Kamenicës, ka hequr dorë nga te drejta e ushtrimit të funksionit të personit te autorizuar ne biznesin e tij privat N.T.P “SHAIPi” me numër biznesi 70218282.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë, z. Faik Rexhepaj, Drejtor në Komunën e Kamenicës, dukë bërë ndryshimet ne biznesin privat, duke u larguar nga personi i autorizuar ne biznesin e tij, janë krijuar rrethana të reja dhe konstatojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues )

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

